



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada- Government

2012-2017

**STRATEGJIA KOMBËTARE E REPUBLIKËS
SË KOSOVËS KUNDËR KRIMIT TË
ORGANIZUAR DHE PLANI I VEPRIMIT**

Qershor 2012, Prishtinë



***STRATEGJIA SHETËRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE PLANI I VEPRIMIT
2012-2017***

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	4
I. PËRMBLEDHJE	5
II. HYRJE	6
III. SITUATA AKTUALE	7
IV. VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMI STRATEGJIK	11
V. PARIMET E PËRGJITHSHME	11
1. Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë.....	11
2. Parimi i prioritetit	11
3. Parimi i profesionalizmit	11
4. Parimi i vazhdimësisë	12
5. Parimi i besueshmërisë	12
6. Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut	12
7. Parimi i sigurisë	12
8. Parimi i proporcionalitetit	12
VI. KORNIZA LIGJORE	12
VII. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL	14
1. Koordinatori Nacional	14
2. Sekretariati	14
3. Ministria e Punëve të Brendshme	14
4. Ministria e Financave	14
5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	14
6. Ministria e Drejtësisë	15
7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës	15
8. Këshilli Prokurorial i Kosovës	15
9. Prokuroritë dhe Gjykatat	15
10. Ministria e Infrastrukturës	15
11. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	15
12. Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit	15
13. Ministria e Punëve të Jashtme	15
14. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	15
15. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	16
16. Ministria e Shëndetësisë	16
17. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	16
VIII. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË	16
IX. ALTERNATIVA E KONSIDERUAR	18
X. ZBATIMI DHE EVALUIMI I STRATEGJISË	18
1. Roli i sistemit të monitorimit	18
2. Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim	19
3. Zgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit.....	19
4. Treguesit e ndërmjetëm	20
5. Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit	20
6. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.....	20
XI. PLANI I VEPRIMIT	20

SHKURTESAT

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DK	Doganat e Kosovës
DKKO	Drejtoria kundër Krimit të Organizuar
ICITAP	Programi për ndihmë ndërkombëtare në trajnim për hetime të krimit
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPiK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KN	Koordinatori Nacional i Strategjisë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
OJQ	Organizatat jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
PK	Policia e Kosovës
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
SECI	Iniciativa për Bashkëpunim Jug-Lindor
ZKM	Zyra e Kryeministrit

I. PËRMBLEDHJE

Kjo strategji është një dokument i cili do ta prezantojë situatën e përgjithshme, situatën aktuale, mekanizmin institucional, dobësitë e tanishme, parimet themelore në luftimin e krimit të organizuar së bashku me disa faktorë kyç për arritje të suksesit dhe më në fund do t'i përcaktojë synimet dhe mënyrat (si dhe institucionet) e mundshme për arritjen e tyre.

Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar e Republikës së Kosovës, për periudhën 2012-2017 është vazhdimësi e strategjisë paraprake dhe mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjisllacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, si dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe praktikrat më të mira ndërkombëtare në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar. Gjersa strategjia paraprake ka pasur si qëllim kryesor themelimin-ndërtimin e mekanizmit institucional, kjo strategji ka për qëllim të ngritë efikasitetin dhe efektivitetin e institucioneve dhe shoqërisë kosovare në këtë fushë.

Kjo strategji është e strukturuar në mënyrë të tillë që të identifikoj qartë objektivat dhe aktivitetet që duhet të përmbushën, në mënyrë që i gjithë mekanizmi institucional të vihet në funksion të parandalimit dhe luftimit me sukses të Krimit të Organizuar në Kosovë, si dhe duke qenë partner serioz me vendet tjera në përpjekjet ndërkombëtare në luftë kundër kësaj dukurie përmes bashkëpunimit ndërkombëtarë.

Diversiteti apo shumëllojshmëria e operacioneve të grupeve të ndryshme kriminale dhe lokacioni apo territori ku ato veprojnë u ofron mjete që në mënyrë më efektive t'i adaptohen situatave të ndryshueshme në një vend, gjersa i shfrytëzojnë dobësitë e bashkëpunimit ndërkombëtarë të organeve për zbatim të ligjit. Në këtë kontekst nuk ka asnjë shtet i cili është tërësisht i sigurt dhe i mbrojtur nga krimi i organizuar, prandaj përjashtim nga kjo nuk bën as Republika e Kosovës. Kjo strategji ka për qëllim që të rris akoma më shumë përpjekjet e Institucioneve të Kosovës në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtarë.

Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar ka për qëllim të ndihmojë zhvillimin dhe implementimin e politikave duke forcuar kapacitetet institucionale kundër këtij lloji të krimit në të gjitha nivelet e organizimit institucional dhe shoqëror.

Politikat për kontrollimin dhe parandalimin e krimit të organizuar duhet të bazohen në të kuptuarit më të thellë se çka paraqet sipas standardeve ndërkombëtare, krimi i organizuar, cila është fushëveprimtaria, metodat e operimeve dhe trendet e krimit në një shtet apo regjion të caktuar.

Qëllimi i strategjisë është që me përdorim sa më racional të burimeve materiale, financiare dhe njerëzore të arrihet ngritja e mekanizmit institucional, bashkëpunimit dhe koordinimit në luftë kundër krimit të organizuar.

Republika e Kosovës bën përpjekje të përmirësojë situatën në fushën e sundimit të ligjit dhe të merret në mënyrë efektive me luftimin e krimit të organizuar i cili është si kusht për progres drejt rrugës evropiane, duke implementuar një politikë të besueshme dhe reale në këtë aspekt.

Qëllimi i kësaj strategjie është zhvillimi i mëtejshëm i politikave për marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë, dhe problemet që janë pasojë e krimit të organizuar.

Hartimi i kësaj strategjie kombëtare orientohet në përcaktimin e objektivave dhe përgatitjen e kuadrit si dhe veprimeve të përbashkëta të të gjitha institucioneve që do të ndërmarrin në pesë vitet e ardhshme (2012-2017).

II. HYRJE

Krimi i organizuar konsiderohet si kërcënim ndaj sigurisë së brendshme si dhe asaj ndërkombëtare. Ky kërcënim mund të manifestohet në forma të ndryshme në përputhshmëri me zhvillimin e jetës ekonomike dhe shoqërore, sidomos në kushtet e globalizimit.

Aktivitetet e krimit të organizuar në periudhën e globalizimit janë perfeksionuar shumë, sepse shumë grupe të krimit të organizuar operojnë me mjete teknike shumë të sofistikuara, e që është vështirë t'iu bihet në gjurmë. Krimi i organizuar në formën më të thjeshtë ka formën e një ndërmarrje të parregulluar e cila kyçet në aktivitete kriminale në forma të ndryshme. Përmes aktiviteteve trans-nacionale. Grupet e krimit të organizuar janë bërë lojtarët kryesor në industrinë ilegale, siç janë prodhimi i drogës dhe trafikimi me qenie njerëzore të cilat kanë shtrirje globale dhe nganjëherë kanë profitin më të madh se GDP-ja e disa shteteve.

Rrjetet ndërkombëtare kriminale, po ashtu kanë fleksibilitet që shpejt dhe me kreativitet t'iu adaptohen përpjekjeve të organeve për zbatimin e ligjit. Këto grupe janë në gjendje që me sukses t'iu shmangen përpjekjeve të organeve për zbatim të ligjit e sidomos organeve përgjegjëse për parandalim dhe luftim të krimit përmes operacioneve të cilat janë të përfshira në arenën ndërkombëtare duke i kaluar shumë herë kufijtë kombëtarë të shteteve.

Pozita gjeostrategjike e Republikës së Kosovës në Ballkan si dhe kushtet e krijuara pas-luftës, e sidomos situata në veri të vendit, ku në veçanti strukturat ilegale që veprojnë atje u mundësojnë grupeve të ndryshme kriminale për të zhvilluar aktivitete të krimit të organizuar. Shkalla e lartë e papunësisë dhe varfëria, gjithashtu kontribuojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti.

Në nivelin global nuk ka pasur një kuptim të përgjithësuar sa i përket krimit të organizuar deri në vitin 2004 kur për herë të parë është aprovuar Konventa e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Krimit të Organizuar.

Kjo konventë paraqet konturat e përkufizimit të krimit të organizuar si dhe definon elementet përbërëse të kësaj vepre penale. Sipas kësaj konvente krimi i organizuar përkufizohet si: “një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personash, që veprojnë në bashkëpunim, me qëllim që të sigurojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një përfitim financiar ose një përfitim tjetër material”.

Konventa në fjalë përmban edhe protokollet shtesë të cilat në mënyrë specifike adresojnë çështje që kanë të bëjnë me:

1. parandalimin, shtypjen dhe dënimin e trafikimit të personave, posaçërisht të grave dhe fëmijëve;
2. kontrabandimin me migrantë, si dhe
3. prodhimin dhe trafikimin e kundërligjshëm me armë, pjesëve të tyre dhe municionin.

Edhe Bashkimi Evropian, bazuar në konventën e lartpërmendur ka bërë përkufizimin për krimin e organizuar. Sidoqoftë, përpjekjet për kuptim të përbashkët të krimit të organizuar në BE kanë zanafillë të mëhershme dhe atë qysh në vitin 1997, ku BE-ja ka ratifikuar një dokument që bazohet në një listë prej 11 karakteristikave të krimit të organizuar.

Republika e Kosovës, në kodin penal të saj, mbështetur edhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Luftimin e Krimit të Organizuar dhe Protokollet e saj, ka përkufizuar krimin e organizuar, si krim i rëndë i kryer nga ndonjë grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore a financiare.

Kodi në fjalë, po ashtu jep edhe përkufizimet për grupin kriminal të organizuar dhe të strukturuar si dhe krimin e rëndë, ekzistenca e të cilit është edhe parakusht për cilësimin e kësaj vepre.

Në bazë të kësaj, me grup kriminal të organizuar nënkuptojmë grup i strukturuar i cili ekziston për një kohë të caktuar dhe i cili vepron në bashkëpunim, me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për përfitim të drejtpërdrejtë ose tërthortë të dobisë pasurore apo financiare.

Grup i strukturuar nënkupton grupin prej tre ose më shumë personave i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e ndonjë vepre penale të çastit dhe nuk do të thotë formalisht t'i ketë të përkufizuara rolet për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë së tij apo strukturën e zhvilluar.

Po ashtu, KPK përkufizon edhe krimin e rëndë dhe atë si vepër penale që dënohet me burgim prej së paku katër vjet.

III. SITUATA AKTUALE

Qasja dhe lufta institucionale në parandalimin dhe luftimin e formave të ndryshme të krimit të organizuar në Republikën e Kosovës, ka vazhduar të udhëhiqet nga vështirësi të shumta në aspektin e koordinimit ndër-institucional, vështirësive në aspektin e koordinimit brenda vet faktorit ndërkombëtar dhe shtrirja e sundimit të ligjit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Efektet shkatërruese direkte dhe ato indirekte të cilat janë rezultat i aktiviteteve kriminale të grupeve të organizuara kriminale brenda dhe jashtë territorit tonë, paraqesin një rrezik shumë të madh për sigurinë e Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Këto efekte është duke i ndier ekonomia jonë e gjendur edhe ashtu ende në fazat e zhvillimit dhe stabilitetit të saj makro-financiarë.

Duke mos njohur barriera në aspektin e nacionalitetit të tyre, grupet kriminale kanë

arritur t'i perfeksionojnë rrugët e tyre të komunikimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve kriminale në aspektin regional dhe transnacional.

Të gjendur në një hapësirë ku mungon institucioni shtetërorë për kontroll të rregullt të vijës kufitare (pjesa veriore e vendit), grupet kriminale (serbe, shqiptare dhe boshnjake), vazhdojnë të kontrollojnë dhe hapin rrugët alternative për të gjitha llojet e kontrabandës, trafikimit me narkotikë, trafikimit me armë dhe qenie njerëzore, ikja nga detyrimet doganore dhe pagesa e taksave të rregullta, dhe formave të tjera të aktiviteteve kriminale.

Format e tilla të organizimit dhe veprimit përbëjnë arkitekturën e re të organizimit të strukturave kriminale në Kosovë.

Grupet kriminale shqiptare për interesat e tyre kriminale bashkëpunojnë me strukturat kriminale në veri të vendit (komunitetit serb dhe boshnjak) të cilat përdoren nga strukturat shtetërore nga Republika e Serbisë për interesat e tyre nacionaliste dhe pretendimet territoriale në raport me Republikën e Kosovës.

Përfitimet e tregut të zi janë milionëshe ndërsa dëmi në ekonominë tonë është kolosal. Nga kjo situatë përfituesit më të mëdhenj janë grupet kriminale, ndërsa më të dëmtuarit dhe rrezikuarit janë ekonomia kosovare dhe qytetarët lokalë të cilët janë izoluar dhe të getoizuar nga grupet e organizuara kriminale që veprojnë në atë pjesë.

Konsiderojmë se jeta normale e qytetarëve të asaj pjesë është drejtpërdrejtë e afektuar nga aktivitetet ditore të grupeve kriminale në drejtim të organizimit dhe zbatimit të urdhrave kriminal nga udhëheqësit e këtyre grupeve.

Një shikim i drejtpërdrejtë i zhvillimeve në aspektin e sigurisë dhe të shtrirjes së tregut të zi dhe aktiviteteve kriminale brenda territorit tonë, reflekton indikacione në drejtim të rritjes së efektit negativ në ekonominë tonë.

Një legjislacion me dispozita më liberale në regjion, një kontroll i pamjaftueshëm i pikave kufitare sidomos në veri të vendit, krijojnë parakushte për shtrirjen e ekonomisë kriminale-të zezë, aktivitet ky që ka filluar të paraqet rrezik serioz për ekonominë e vendit, çrregullimin e konkurrencës dhe rrezikimin e funksionimit demokratik të institucioneve.

Kjo analizë e situatës aktuale në raport me aktivitetet e grupeve kriminale në Republikën e Kosovës përfshinë vetëm fenomenin e trafikimit me narkotikë, armë dhe municione, trafikimi me qenie njerëzore, dukurinë e korrupsionit dhe shpëlarjes së parave dhe trafikimin me emigrantë (nga jashtë Kosovës kur grupet kriminale përdoren si vend transit dhe grupet kriminale si grupe përkrahëse dhe logjistike, dhe trafikimin e qytetarëve tanë për në vendet e Bashkimit Evropian përmes falsifikimit të dokumentacionit).

Një pjesë e trafikimit me substanca narkotike kryhet përmes pjesës veriore të pakontrolluar nga strukturat e sigurisë së Republikës së Kosovës. Policia lokale atje e cila vepron nën uniformën e Policisë së Kosovës, zhvillon aktivitetin e saj nën urdhrat e shërbimeve sekrete të cilat nuk lejojnë vendosjen e rendit dhe ligjit por edhe mbështesin udhëheqësit e strukturave kriminale të cilat kontrollojnë tregun e kokainës nga Republika e Serbisë për në Kosovë.

Pjesa tjetër e drogave të lehta si marihuana kryesisht vjen nga tregu i vendeve të regjionit përmes rrugëve ilegale apo të kamufluara në sasi të vogla përmes pikave kufitare.

Heroina si kategori e narkotikëve më pak e konsumuar në Kosovë, kryesisht vjen nga shtetet e lindjes përmes rrugëve dhe grupeve të organizuara kriminale për tu transportuar pastaj për në vendet e tjera të Bashkimit Evropian.

Kontrabanda si dukuri e cila është duke prekur negativisht zhvillimin ekonomik të Kosovës, përfshin aktivitetet kriminale të kontrabandimit me naftë dhe derivate të naftës, duhanit, alkoolit, barnave të ndryshme, mallra të ndryshme të kontrabanduara, të cilat i kushtojnë buxhetit miliona euro dhe njëherit janë shkaktari kryesorë i çrregullimit të konkurrencës dhe efekteve anësore të pakontrolluara në vet shëndetin e konsumatorit në Republikën e Kosovës.

Lidhur me dukurinë e trafikimit me qenie njerëzore, Kosova vazhdon të jetë destinacion i rrugëve të ndryshme kriminale kryesisht trafikimit nga vendet e lindjes për në territorin tonë. Grupet e organizuara kriminale shfrytëzojnë zbrastësitat ekzistuese ligjore dhe ato administrative për trafikimin për qëllime të ushtrimit të prostitucionit brenda territorit tonë. Për shkak të përfitimeve të mëdha strukturat kriminale kanë arritur që në vazhdimësi përmes formave dhe rrugëve kriminale duke përdorin ryshfetin dhe duke korruptuar zyrtarët kompetentë t'i sigurojnë leje qëndrim dhe leje pune viktimave të trafikimit.

Dukuri që shqetëson dhe paraqet kërcënim serioz është edhe trafikimi me armë dhe municion. Kosova është vend destinacioni por edhe vend transiti, kryesisht për trafikim në mes të strukturave kriminale që veprojnë në vendet e rajonit. Pjesa veriore e Republikës së Kosovës vazhdon të përdoret për futjen e armëve dhe municioneve për tregun e brendshëm por edhe atë në regjion. Këto rrugë përdoren për trafikimin dhe futjen e armëve të shkurtra kryesisht prodhim nga vet Serbia, për tregun Kosovar por edhe atë të vendeve tjera të regjionit.

Ndryshimet socio-politike në vendet e Afrikës së Veriut dhe të lindjes së mesme nuk e lanë pa e prekur edhe Republikën e Kosovës sa i përket trafikimit me emigrantë. Ky lloj i aktivitetit kriminal përfshin dy lloj të aktiviteteve të grupeve kriminale, trafikimin e shtetasve tanë për në vendet e ndryshme të Bashkimit Evropian dhe mundësinë e krijimit dhe përkrahjes së rrugëve transitorë për emigrantët ilegal nga Afrika Veriore dhe Lindja e Mesme.

Në të dyja këto raste grupet kriminale serbe dhe shqiptare shfrytëzojnë aktivitetin e strukturave të krimit të organizuar me karakter ndërkombëtarë.

Korrupsioni dhe shpëlarja e parave përbëjnë formën më të re dhe më të avancuar në jetën institucionale dhe përbëjnë njërin ndër rreziqet më të mëdha për sigurinë nacionale dhe atë të qytetarit. Shumat e mëdha të parave të fituara në mënyrë të kundërligjshme përmes zhvatjeve apo forma të tjera të korrupsionit, kryesisht janë futur në tregun e patundshmërive, lojërave të fatit dhe ndërtimeve të larta kolektive.

Në mungesë të infrastrukturës ligjore për prejardhjen e pasurisë, pengimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e pasurisë, grupet kriminale kanë arritur t'i legalizojnë pasuritë e tyre milionëshe të dala nga aktivitetet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Kosovës(korniza e brishtë ligjore).

Duke u bazuar në analizat e rregullta të strukturave të sigurisë në Republikën e Kosovës dhe analizat e rregullta të institucioneve të sigurisë në Bashkimit Evropian dhe më gjerë, indikacionet e para flasin për diversitetin dhe perfeksionimin e grupeve kriminale në Bashkimin Evropian në përgjithësi dhe në Republikën e Kosovës dhe në

regjionin tonë në veçanti. Grupet kriminale janë në gjendje që të përshtaten dhe veprojnë në varësi nga kushtet për ushtrimin e aktivitetit kriminal. Këto grupe janë bërë shumë më shumë bashkëpunuese dhe polikriminale.

Ajo që institucionet e sigurisë duhet të kenë kujdes, është se këto dukuri nuk mund të luftohen në mënyrë dhe rrugë individuale vetëm nga agjencitë e zbatimit të ligjit, parandalimi dhe luftimi i grupeve kriminale dhe aktivitetit të tyre duhet të trajtohet nga një dimension i ekzistimit të një cikli të pandërprerë të lidhjeve dhe bashkëpunimit nga grupet lokale, regjionale dhe ato ndërkombëtare. Parandalimi dhe luftimi i krimit kërkon bashkëpunim dhe koordinim ndërinstitucional, këto dukuri nuk mund të luftohen vetëm nga agjencitë e sigurisë, kjo kërkon një nivel qendror të koordinimit dhe analizës së inteligjencës me qëllim të ndikimit në parandalim dhe luftim.

Identifikimi, lokalizimi dhe profilizimi i grupeve kriminale në aspektin lokal, do të ndihmonte institucionet e sigurisë në identifikimin, lokalizimin dhe profilizimin e grupeve kriminale me karakter regjional dhe ndërkombëtarë. Indikacionet flasin për një fillim të ri të ndikimit edhe në strukturat e gjyqësorit dhe ato të Policisë së Kosovës.

Kriza ekonomike me efekt të veçantë në eurozonë, ka zvogëluar përkrahjen financiare të Bashkimit Evropian për vendet në zhvillim në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar. Kjo është njëra ndër vështirësitë e cila ka filluar të ndihet edhe tek planifikimet buxhetore të strukturave të sigurisë në aspektin e ndihmës ndërkombëtare në pajisje dhe ofrimin e ndihmës në aspektin e ekspertizës profesionale.

Më shqetësuesja mbetet shfaqja e indikacioneve për një fillim të përfshirjes së zyrtarëve nga agjencitë e sigurisë dhe institucionet e gjyqësorit dhe prokurorisë në aferat korruptive dhe mbulimin dhe kamuflimin e aktiviteteve kriminale dhe përkrahjen e grupeve kriminale brenda territorit tonë. Mbetet element shqetësues infiltrimi i strukturave kriminale dhe grupeve të interesit në kuadër të organeve vendimmarrëse por edhe në vet strukturat operative dhe informative të Policisë së Kosovës. Vështirësitë shfaqen në rastet e dekonspirimit të veprimeve operative në drejtim të parandalimit dhe luftimit të grupeve të organizuara kriminale.

Konsiderojmë se një trajtim dhe koordinim më gjithëpërfshirës në aspektin lokal, regjional dhe ndërkombëtarë do të jetë çelësi i suksesit në luftë kundër krimit të organizuar.

Trajtimi strategjik, qasja profesionale dhe përdorimi i praktikave më të mira, vetëm sa do të ndihmonte në identifikimin, profilizimin dhe penalizimin e strukturave kriminale të cilat dita ditës janë duke u perfeksionuar në mbulimin e aktiviteteve të tyre.

Institucionet përgjegjëse duhet të fillojnë hartimin dhe fuqizimin e politikave të shëndosha kadrovike sidomos në kuadër të Agjencive të Sigurisë dhe institucioneve për zbatimin e ligjit. Politikat gjithëpërfshirëse dhe trajtimi i fenomeneve negative në aspektin strategjik dhe institucional duhet të studiohet dhe trajtohet jo vetëm nga institucionet e sigurisë por mendimi dhe trajtimi duhet të merret edhe nga profesionistët dhe individët të cilët hulumtojnë dhe studiojnë fenomenet e ndryshme negative të shoqërisë.

Agjencitë e sigurisë në koordinim dhe bashkëpunim me kanalet e inteligjencës duhet

të punojnë në parandalimin, identifikimin dhe shkatërrimin e bazave të logjistikës të cilat po përdoren nga grupet kriminale gjatë transitit të zhvillimit të aktiviteteve të tyre.

Një studim më i hollësishëm i tregut aktual kriminal brenda territorit tonë por edhe më gjerë vetëm sa do të ndihmonte në identifikim më të lehtë të llojit dhe mënyrave të veprimit të grupeve kriminale.

IV. VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMI STRATEGJIK

Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie është ndërtimi i një shoqërie të sigurt duke minimizuar dhe pamundësuar aktivitetet e krimit të organizuar në territorin e Republikës së Kosovës.

Misioni

Misioni i kësaj strategjie është zhvillimi i politikave për marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë si dhe problemet që janë pasojë e krimit të organizuar.

Kjo arrihet duke përcaktuar objektivat strategjike, objektivat specifike si dhe aktivitete konkrete për realizimin e strategjisë.

Qëllimi strategjik

Qëllimi i kësaj strategjie është që me përdorim sa më racional të burimeve materiale, financiare dhe njerëzore të zhvillojë politika për marrjen e përgjegjësive për mbrojtjen e individit dhe shoqërisë dhe problemet që janë pasojë e krimit të organizuar.

V. PARIMET E PËRGJITHSHME

Strategjia Kombëtare kundër Krimit të Organizuar dhe Plani i Veprimit udhëhiqen nga parimet vijuese:

- 1. Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë** – Veprimet e ndërmarra duhet të kenë bazë në dispozitat e parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.
- 2. Parimi i prioritetit** – Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar është prioritet për institucionet e Republikës së Kosovës. Përkushtimi i përgjithshëm për t'u marrë seriozisht me këtë problem është element qenësor.
- 3. Parimi i profesionalizmi** – Luftimi i krimit të organizuar kërkon ekspertë të mirë, shkëmbim të përvojave, mjete të përshtatshme /praktikat më të mira. Kjo nënkupton kombinim të trajnimit, edukimit dhe zhvillimit profesional për institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe përkujdesjen për të rekrutuar vetëm specialistët e cilësisë më të mirë.
- 4. Parimi i vazhdimësisë** – Aktivitetet duhet të shihen si pjesë e një strategjie të vazhdueshme. Kjo është sidomos e rëndësishme për arsye se do të ekzistojnë përkufizimet kohore administrative/procedurale si dhe për arsye se iniciativat /aktivitetet e ndryshme do të jetë e nevojshme të ndërliqen në veprime të cilat

do të zgjasin me vite të tëra.

5. **Parimi i besueshmërisë** - Institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar duhet të kujdesën për ndërtimin e besimit në ruajtjen e të dhënave dhe informacioneve nga keqpërdorimi nga ata që kanë qasje në to.
6. **Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut** - Nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të të gjithë individëve pavarësisht përkatësisë etnike, gjinisë, moshës, religjionit gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar.
7. **Parimi i sigurisë** - Ky parim nënkupton garantimin e të drejtës për siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët nëpërmjet parandalimit dhe zvogëlimit të të gjitha formave të krimit të organizuar.
8. **Parimi i proporcionalitetit** - Nënkupton ushtrimin e autoritetit të institucioneve që merren në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që nevojitet për të arritur objektivat legjitim, me mjete dhe metoda të përshtatshme, kohë sa më të shkurtër të mundshme si dhe pasoja sa më pak të dëmshme.

VI.KORNIZA LIGJORE

Në luftë kundër krimit të organizuar, Republika e Kosovës ka në fuqi një bazë të gjerë legjislative, ku si legjislacioni parësor mund të përmenden por nuk kufizohen vetëm në:

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
2. Kodi Penal i Kosovës;
3. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës;
4. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë;
5. Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë;
6. Ligji nr. 03/L063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë;
7. Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat;
8. Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;
9. Ligji nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
10. Ligji nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
11. Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
12. Ligji nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë;
13. Ligji nr. 04/L-015 për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;
14. Ligji nr. 04/L-043 për mbrojtjen e Informatorëve;
15. Kodi nr. 03/L-193i Drejtësisë për të Mitur;
16. Kodi Doganor dhe i Akcizave;
17. Ligji nr. 03/L-191 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
18. Ligji nr. 03/L-183 për Zbatimin e Sanksionove Ndërkombëtare;
19. Ligji nr. 03/L-137 për Departamentin e Mjekësisë Ligjore;
20. Ligji nr. 03/L-142 për Rendin dhe Qetësinë Publike;
21. Ligji nr. 03/L-196 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit;

22. Ligji nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës;
23. Ligji nr. 03/L-216 mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë;
24. Ligji nr. 04/L-030 për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale;
25. Ligji nr. 04/L-31 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale;
26. Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare;
27. Ligji nr. 04/L-078 për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve;
28. Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
29. Ligji nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikro-financiare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare;
30. Ligji për Mbrojtjen Sociale;
31. Ligji nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës;
32. Ligji nr. 03/L166 për Parandalimin dhe Luftimin Kibernetik;
33. Ligji nr. 03/L-063 për Agjencinë kundër Korrupsionit;
34. Ligji nr. 04/L051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik;
35. Ligji nr. 03/L-238 për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës;
36. Ligji nr. 03/L141 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

Po ashtu, vlen të theksohet se Republika e Kosovës me qëllim të kompletimit të infrastrukturës ligjore që ndikon në luftën kundër krimit të organizuar është në proces të hartimit dhe miratimit të projektligjeve, ku me theks të veçantë vlen të përmenden:

1. Projektligji për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale;
2. Projektligji për Pengimin e Pastrimit të Parave;
3. Projektligji për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar;
4. Projektligji për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik;
5. Projektligji për Transaksione të Pagesave;
6. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale;
7. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Penal;
8. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale;
9. Projektligji për Klasifikim të Informatave dhe Verifikimin e Besueshmërisë;
10. Projektligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
11. Projektligji për Gjykatat;
12. Projektligji për Prokurorinë Publike;
13. Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe i Akcizave nr. 03/L-109- 04/L-099 datës 06.01.2012.

Konventat dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, që ndikojnë në luftën kundër krimit të organizuar janë:

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
3. Konventa kundër torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jo

njerëzore dhe poshtëruese.

Republika e Kosovës, bën përpjekje për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, më ç'rast do t'i mundësohet ratifikimi dhe zbatimi i konventave dhe instrumenteve tjera ndërkombëtare në luftë kundër krimit të organizuar.

VII. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë mekanizmat të cilët kanë rol dhe rëndësi në koordinimin e aktiviteteve në luftë kundër krimit të organizuar.

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar në Republikën e Kosovës, detyrë dhe përgjegjësi kanë këto institucione:

- 1. Koordinatori Nacional** - Koordinatori Nacional është organ individual përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me luftën kundër krimit të organizuar.
- 2. Sekretariati** - E drejtë, detyrë themelore dhe përgjegjësi e sekretariatit është mbledhja e informacioneve dhe të dhënave nga institucionet tjera, me qëllim të analizimit dhe vlerësimit të atyre informatave, si dhe përgatitja e raporteve analitike për Koordinatorin Nacional.
- 3. Ministria e Punëve të Brendshme** - MPB ka rol funksional në arritjen e objektivave të caktuara në këtë strategji. Policia e Kosovës si agjenci për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së, ka përgjegjësinë e plotë në luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar. Policia e Kosovës dhe Dogana, së bashku me institucionet tjera janë akter kyç në parandalimin dhe luftimin e aktiviteteve kriminale jo vetëm në Kufirin e Kosovës por edhe në gjithë territorin e Kosovës.
- 4. Roli i Ministrisë së Financave** – MF përmes Doganave, Njësisë së Inteligjencës Financiare dhe Administratës Tatimore, do të ndihmojë në parandalimin e qarkullimit ndërkufitarë të mallrave dhe materialeve të cilat kanë për qëllim veprimtaritë që ndërlidhen me të gjitha format e krimit të organizuar. Roli i kësaj ministrie ka të bëjë edhe me ndihmën në identifikimin, raportimin dhe bllokimin e financimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me krimin e organizuar. Dogana e Kosovës ka për mision mbrojtjen e shtetit, ekonomisë dhe qytetarët përmes kontributeve në çështje ekonomike dhe kontributit për siguri. Njësinë e Inteligjencës Financiare, si institucion i pavarur qendror dhe kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave, përgjegjës për pranimin, analizimin dhe shpërndarjen e informacioneve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. NJIF me qëllim të parandalimit dhe luftimit sa më efikas të shpëlarjes së parave, bashkëpunon me të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit si: Policinë e Kosovës, Doganat e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës, Prokurorinë etj, si dhe me FIU (institucione të ngjashme) ndërkombëtare me qëllim të këmbimit të informatave në luftë kundër shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit.
- 5. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë** - Në luftimin e krimit të organizuar do të ndihmojë në parandalimin e qarkullimit të mallrave, ofrimit të shërbimeve

nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit në mbështetje të institucioneve.

- 6. Roli i Ministrisë së Drejtësisë** - Ministria e drejtësisë është pjesë e rëndësishme e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe angazhohet që të:
 - Siguroj kushte të nevojshme për prokuroritë e në veçanti për Prokurorinë Speciale, të cilën e konsideron si një institucion kyç në luftimin e krimit të organizuar;
 - Forcimin dhe funksionalizimin e sundimit të ligjit, që do të ndihmoj në luftën kundër krimit të organizuar;
 - Kompletimi i legjislacionit në fushën e sundimit të ligjit për të shtuar efikasitetin në realizimin e synimeve strategjike në luftën kundër kriminalitetit lidhur me krimin e organizuar.
- 7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës** - Siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale dhe të paanshme, me qëllim që sistemi gjyqësorë të jetë sa më efikas në luftë kundër krimit të organizuar dhe formave tjera të kriminalitetit.
- 8. Këshilli Prokurorial i Kosovës** - Siguron që sistemi prokurorial në Kosovë të jetë i pavarur, i paanshëm dhe profesional në ushtrimin e ndjekjes, hetimit dhe zbulimit të veprave penale dhe të përfaqëson në gjykata aktet akuzuese në emër të shtetit.
- 9. Prokuroritë dhe Gjykatat**- Janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen penale të kryesve, ndëshkimin adekuat të tyre, për konfiskimin e pasurisë dhe asetëve të fituara me anë të aktiviteteve kriminale.
- 10. Ministria e Infrastrukturës** – Ka rol në luftën kundër krimit të organizuar nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit me institucionet tjera në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të veta për dhënien e mbështetjes të institucioneve të cilat angazhohen në parandalimin dhe luftimit e krimit të organizuar.
- 11. Agjencia Kosovare për Inteligjencë**- Është organ i cili mbledhë, vlerëson dhe përcjell informacionet në lidhje me kërcënimet nga aktivitetet e krimit të organizuar ndaj sigurisë së Kosovës.
- 12. Agjencia kundër Korrupsionit** - Është organ i pavarur dhe i specializuar i cili merret me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Agjencia mbledhë, analizon dhe kryen hetimet administrative paraprake për rastet e dyshuara për korrupsion dhe i përcjellë në prokurori. Mbikëqyrë pasurinë e zyrtarëve të lartë publik dhe parandalon konfliktin e interesit.
- 13. Ministria e Punëve të Jashtme**- Ka rol në drejtim të dhënies së ndihmës për bashkëpunim ndërkombëtarë në luftën kundër krimit të organizuar.
- 14. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë** – Luan rol të rëndësishëm në parandalimin e krimit të organizuar nëpërmjet edukimit, përmes plan-programeve mësimore, qasjes ndër-programore dhe aktiviteteve të ndryshme jashtë-programore.
- 15. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve** - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në luftë kundër krimit të organizuar ka rol në organizimin e aktiviteteve (fushatave) sensibilizuese me të rinj dhe grupeve jo formale, me qëllim të

vetëdijesimit për rrezikun e krimin të organizuar (trafikimi, droga dhe prostitucioni) dhe parandalimit të tij.

- 16. Roli i Ministrisë së Shëndetësisë** - Ministria e Shëndetësisë merr pjesë në parandalimin, trajtimin, rehabilitimin mjekësor të viktimave të krimin të organizuar. Këtë e realizon përmes akteve ligjore, strategjive, planeve përkatëse, protokolleve klinike, trajtimeve dhe sigurimit të materialit dhe medikamenteve.
- 17. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale** - Roli i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është të hartojë plane dhe programe për mbrojtjen e familjes, individit në atë mënyrë që të jap përkrahje sociale, si dhe bashkëpunon me institucione tjera për identifikimin, këshillimin dhe trajtimin e viktimave të krimin të organizuar.

Në kuadrin institucional, një rol të rëndësishëm për parandalim dhe luftim të krimin të organizuar luajnë edhe institucionet tjera vendore dhe institucionet ndërkombëtare partnere prezentë në Kosovë por edhe jashtë saj.

VIII. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Strategjia Kombëtare kundër Krimin të Organizuar mbështetet në këto objektiva strategjike:

- **Fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve në parandalimin dhe luftimin e krimin të organizuar.**
- **Zhvillimi i bashkëpunimit dhe koordinimit në mes akteve vendor dhe ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e krimin të organizuar;**
- **Parandalimi dhe luftimi i formave të krimin të organizuar;**
- **Vetëdijesimi i qytetarëve për pasojat e krimin të organizuar.**

1. Fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve në parandalimin dhe luftimin e krimin të organizuar

Për të luftuar me sukses krimin e organizuar është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të kenë kapacitetet e mjaftueshme njerëzore të aftësuara dhe të specializuara për luftë efektive kundër krimin të organizuar. Për shkak të kompleksitetit që ka krimi i organizuar është shumë e rëndësishme që strukturat që merren me parandalimin dhe luftimin e krimin të organizuar të kenë mjetet teknike dhe teknologjinë bashkëkohore dhe të standardizuar. Gjithashtu, është shumë e nevojshme sigurimi i hapësirave të domosdoshme për punë për të gjitha institucionet përgjegjëse si dhe organizimi institucional në funksion të forcimit të kapaciteteve në luftë kundër krimin të organizuar.

Ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimin të organizuar përfshinë një sërë masash të cilat kanë për qëllim:

- 1.1. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar;
- 1.2. Rishikimi dhe harmonizimi i kornizës ligjore;
- 1.3. Krijimi i hapësirës së mjaftueshëm dhe pajisja me mjete të domosdoshme për njësitë që merren me parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar;
- 1.4. Monitorimi, evaluimi dhe rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit;

2. Zhvillimi i bashkëpunimit dhe koordinimit në mes **akterëve vendor dhe ndërkombëtar në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar**

Për tu luftuar me sukses krimi i organizuar është e nevojshme që të ekzistojë bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit, midis sektorëve dhe niveleve të organizimit.

Me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në luftë kundër krimit të organizuar, është i rëndësishëm bashkëpunimi dhe koordinimi midis institucioneve përgjegjëse për parandalim dhe luftim të kësaj dukurie.

Bashkëpunimi dhe koordinimi ndër-institucional midis institucioneve është kusht për një punë më efektive në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, sidomos në procesin e shkëmbimit të informatave, shkëmbim të përvojave si dhe veprimeve apo operacioneve të përbashkëta.

Të gjitha institucionet përgjegjëse duhet të marrin pjesë aktive në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve. Bashkëpunimi dhe koordinimi institucional përfshinë një sërë masash të cilat kanë për qëllim:

- 2.1. Ngritja dhe avancimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional;
- 2.2. Ngritja dhe avancimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar;
- 2.3. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare;

3. Parandalimi dhe luftimi i formave të krimit të organizuar

Përmes parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar synohet organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme me qëllim të vetëdijesimit të personelit të institucioneve përgjegjëse, si dhe opinionit në përgjithësi për pasojat që shkakton krimi i organizuar.

Institucionet e Republikës së Kosovës janë të përkushtuara për të luftuar të gjitha format e krimit të organizuar duke përfshirë por jo kufizuar vetëm: luftën kundër drogave, trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandimit me migrantë, armëve, derivate, alkoolit, vepra të artit, vepra të trashëgimisë kulturore etj.

Për të përforcuar përpjekjet për parandalimin dhe luftim të krimit është e rëndësishme përpjekja për zbatimin e Policisë së Udhëhequr nga Inteligjenca.

Parandalimi dhe luftimi i formave të krimit të organizuar përfshinë një sërë masash të cilat kanë për qëllim:

- 3.1 Parandalimi i gjitha formave të kontrabandës, evazionit fiskal dhe krimeve tjera.
- 3.2 Luftimi i kontrabandës dhe krimeve tjera në tërë territorin e Kosovës, duke aplikuar teknikat moderne të hetimit.
- 3.3 Ngritja e efikasitetit të hetimeve të integruara financiare, kyçja në hetime paralele;

4. Vetëdijesimi i qytetarëve për pasojat e krimit të organizuar

1. Ngritja e vetëdijesimit të qytetarët për pasojat e krimit të organizuar për shoqërinë dhe efektet e tij destabilizues në ekonominë e vendit.

IX. ALTERNATIVA E KONSIDERUAR

Gjatë hartimit të kësaj strategjie janë kryer shume aktivitete të cilat kanë pasur karakter hulumtues dhe analitikë. Puna hulumtuese dhe analitike ka rezultuar në fund me formulimin e objektivave strategjike, specifike dhe aktiviteteve të domosdoshme, institucioneve përgjegjëse dhe mbështetëse si dhe indikatorët matës për implementimin e aktiviteteve.

Si rezultat i punës dhe angazhimit të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës dhe mbështetjes nga institucionet tjera ndërkombëtare, janë identifikuar alternativat më të mira respektivisht objektivat më të përshtatshme të cilat do të ndihmojnë Republikën e Kosovës në parandalim dhe luftim e krimit të organizuar.

Kosova ka burime dhe kapacitete për t'u ballafaquar dhe për të adresuar kërcënimet e brendshme terroriste.

Problemit të krimit të organizuar në shoqërinë kosovare duhet kushtuar kujdes të veçantë sidomos nga institucionet shtetërore, por dhe nga shoqëria civile në përgjithësi si dhe bashkërendimi i aktiviteteve mes tyre. Prandaj hartimi i kësaj strategjie e sidomos objektivat dhe aktivitetet janë të fokusuara në drejtim të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve të të gjitha institucioneve në parandalimin në rend të parë, por edhe në luftimin e krimit të organizuar. Të gjithë mekanizmat shtetëror, institucional dhe shoqëror duhet të angazhohen në parandalimin dhe zbulimin e të gjitha formave të krimit të organizuar për të evituar rrezikun që paraqet kjo në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjatë punës së grupit punues në hartimin e kësaj strategjie janë marrë në konsideratë shumë alternativa duke i studiuar ato si dhe analizuar në tërësi, dhe si rezultat i kësaj janë zgjedhë alternativat më të mira të cilat ofrojnë mundësinë për të pasur sukses në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar.

X. ZBATIMI DHE EVALUIMI I STRATEGJISË

1. Roli i sistemit të monitorimit

Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike si dhe aktiviteteve. Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të objektivave dhe efektshmërisë së aktiviteteve përkatëse, janë pjesë integrale e strategjisë dhe komponentë kryesorë të procesit të zbatimit të saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe përcaktuar drejtimet e rregullimeve, veçanërisht lidhur me aktivitetet.

Procesi i monitorimit do të realizohet nga institucionet përgjegjëse me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesuara.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë janë:

- Kapacitetet institucionale;
- Treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës tre vjeçare;
- Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;
- Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

2. Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet bartëse dhe përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit.

- Ministria e Punëve të Brendshme, si bartëse dhe përgjegjëse kryesore për realizimin e objektivave, do të krijojë Njësinë e Monitorimit dhe Vlerësimit të Strategjisë në vartësi të Koordinatorit Nacional kundër Krimit të Organizuar. Kjo njësi do të monitorojë treguesit më të rëndësishëm që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar. Në fund të çdo viti, duhet të përgatisë një raport progresi mbi shkallën e realizimit të objektivave.
- Ministritë e linjës (MD, MASHT, MF, MSH, MPMS, MI, MPB, MMPH, MKRS, MBZHR) do të përgjigjen për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve që kanë si bartës këto ministri ose institucione në vartësi të tyre, duke përfshirë edhe prokuroritë dhe gjykatat. Këto institucione do t'i raportojnë periodikisht Koordinatorit Nacional, në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara.
- Organizatat jo-qeveritare, do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e strategjisë në tryeza të përbashkëta që do të organizohen nga Koordinatori. Në këto tryeza, shoqëria civile do të paraqesë raporte vëzhguese që lidhen me projektet dhe programet që ato kanë realizuar.

3. Zgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit

Treguesit përfundimtarë

1. Numri i ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse, që kanë hyrë në fuqi pas miratimit të strategjisë;
2. Strukturat e krijuara (Koordinatori, Sekretariati);
3. Numri i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe të nënshkruara me shtetet tjera;
4. Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë;

5. Numri i çështjeve të trajtuara nga Policia, Prokuroria dhe Gjykata brenda dhe jashtë;
6. Konfiskimi i pasurive të paluajtshme, armëve, duhanit, veturave, parave dhe sendeve të tjera që janë fituar me kryerjen e veprës penale;
7. Numri i personave të arrestuar;
8. Numri dhe lartësia e dënimeve të shqiptuara;
9. Sekuestrimi i pasurive që janë rezultat i veprave penale të krimit të organizuar.

4. Treguesit e ndërmjetëm

Janë treguesit e monitorimit të aktiviteteve në Planin e Veprimit kundër Krimit të Organizuar.

5. Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit

1. Sistemi i standardizuar i mbledhjes dhe përpunimit të informacionit;
2. Të dhënat administrative, Statistike të MPB (Policisë), MD, MSH, MEF (Dogana, ATK), MASHT, Prokurorisë, Gjykatave, MPMS;
3. Mekanizmat kombëtarë dhe ndërkombëtarë referues;
4. Anketime dhe vrojtime të popullatës mbi shkallën e vetëdijesimit për çështjet kundër krimit të organizuar.

6. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të shpërndahen për të bërë të njohur progresin në luftën kundër krimit të organizuar, përkatësisht në arritjen e objektivave strategjike dhe objektivave specifike. Pasi të hartohen raportet e progresit, bazuar mbi të dhënat dhe vrojtimit, ato do të shpërndahen ndërmjet përdoruesve të cilët do të jenë:

1. Institucionet shtetërore qendrore dhe lokale;
2. Partnerët ndërkombëtarë;
3. Shoqëria civile;
4. Media;
5. Publiku i gjerë.

Përgjegjës kryesor për shpërndarjen e rezultateve është Koordinatori Nacional. Gjithashtu, publikimi i rezultateve do të bëhet edhe nëpërmjet mediave ose duke organizuar seminare dhe tryeza, për të nxjerrë konkluzione në lidhje me ecurinë e strategjisë.

XI. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit hartohet brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar.

Plani veprues për zbatimin e kësaj strategjie do të përmbajë:

- Objektivat strategjike;
- Objektivat specifike;

- Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave;
- Përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe aktivitet;
- Saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit objektiv;
- Përcakton burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve;
- Përcakton indikatorët apo treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

Plani Veprues duhet të tregoj lidhshmëri me kornizën e përgjithshme të Strategjisë Kombëtare kundër Krimit të Organizuar të Republikës së Kosovës.